



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 1331 Prot  
12

Tiranë më 08/02/2024

**N J O F T I M**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, shpall audicionin e brendshëm për për pozicionin e punës **Koncertmaestër (Pianist) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.**

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se audicioni do të zhvillohet në **datën 27.02.2024, ora 16:00, në Hollin Koncertor** brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Për t'i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t'i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme për vendin vakant Koncertmaestër (Pianist) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.

**Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 20.02.2024, ora 16:30 një letër shprehje interesi për vendin vakant.**

**Programi:**

**\*Programi për konkurimin është interpretimi i (përzgjedhja për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) veprave të mëposhtme:**

G. Puccini      Madama Butterfly – Akti 1 nga “Viene la sera” (n. 116) deri ne fund te aktit  
Madama Butterfly – Skena e letrës (Akti 2, n. 41 deri tek n. 60)

- G. Puccini Tosca – Dueti Mario, Mario, Mario...son qui! (Akti 1, tri masa para n. 25)  
Tosca – “Ov’è Angelotti” (Akti 2, n. 19 deri tek n. 51)
- P. Mascagni Cavalleria Rusticana – “Il cavallo scalpita”, “Inneggiamo”, “Voi lo sapete o mamma”
- G. Verdi Aida – Gran finale secondo
- G. Verdi Attila – Akti i tretë komplet

Një koncert për piano dhe orkestër, sipas dëshirës së kandidatit/es.

### **Shënim:**

**-Komisioni ruan të drejtën:**

- 1. Të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit**
- 2. Të kërkojë këndimin e partëve solistike të veprave të përcaktuara si më lart.**
- 3. Të kërkojë shpjegimin e kuptimit të teksteve të kënduara nga çdo personazh dhe t’i kërkojë kandidatit që të flasë për kompozitorët dhe veprat që janë program i audicionit.**
- 4. Të kërkojë simulimin e një ore prove me një këngëtar, relative e veprave të kërkuara në program.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:  
[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al)

**DREJTORE E PËRGJITHSHME  
ABIGEILA VOSHTINA**

